



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1353/5 prot.

Tiranë, më 24.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 50, datë 24.07.2026

PËR KONTROLLUESIN, SHOQËRIA “SUPERMART” SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit, si dhe provave të administruara në përfundim të hetimit administrativ në ngarkim të Kontrolluesit, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k. (në vijim “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 113, datë 18.05.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u organizua grupi i punës, i cili kreu hetimin administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të të dhënave personale (PIMS)”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M21525018U, me objekt aktiviteti “Objekti i shoqërisë është kryerja e aktivitetit në fushën e e-commerce. Shitja me shumicë dhe/ose pakicë nëpërmjet platformave online etj.”.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “vizitorë” etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se Kontrolluesi, ndër të tjera, përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, punonjës, nëpërmjet dosjeve fizike dhe të dhëna personale të klientëve në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit të platformës së tregtisë elektronike supermart.al. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues lidhur me asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi dhe mosdokumentimi i procedurave të brendshme rregullatore për asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013, të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim “Vendimi nr. 6”), demonstroi mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Rezulton se Kontrolluesi ka nënshkruar Kontratën për Shërbimin e Kreditimit të Klientit, datë 28.04.2022, me subjektin IuteCredit Albania sh.a., me objekt “Ndërmjetësimin për përpunimin e kërkesave për kredi dhe nënshkrimin e kontratave të kredisë për klientët e Kontrolluesit”, si dhe Marrëveshjen për Ofrimin e Shërbimeve dhe Llogarisë së Pagesës së Parave Elektronike, datë 10.06.2024, me subjektin IutePay sh.p.k., me objekt “Mundësimin e pranimit të pagesave elektronike nga klientët e Kontrolluesit nëpërmjet Sistemit IutePay”.

Nga analizimi i përmbajtjes së marrëveshjeve të mësipërme konstatohet se asnjëra prej tyre nuk specifikon shprehimisht rolin ligjor të palëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të klientëve të Kontrolluesit, kategoritë e të dhënave personale që shkëmbehen ndërmjet palëve, qëllimin e përpunimit, afatin e ruajtjes, si dhe masat konkrete tekniko-organizative të detyrueshme për t’u zbatuar, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Gjithashtu, nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo delegim i përpunimit të të dhënave personale duhet të realizohet përmes një kontrate/marrëveshjeje të shkruar dhe të detajuar, e cila përcakton qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave, masat e sigurisë që do të zbatohet përpunuesi, përgjegjësitë ligjore dhe procedurat për kontrollin dhe raportimin. Kjo siguron që delegimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që

të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi disponon rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Grupi i hetimit administrativ konstaton se në rregullore nuk janë specifikuar kategoritë e të dhënave personale sipas subjekteve përkatëse, të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave, si dhe nivelet e aksesit në të dhënat personale të punonjësve të SuperMart Albania, në përputhje me proceset përpunuese të cilat kryejnë, si disa nga masat teknike e organizative që duhet të ndërmarrë Kontrolluesi për të garantuar sigurinë e përpunimit dhe për të mbrojtur të dhënat personale nga aksesit i paautorizuar, sipas parashikimeve të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përshtatja dhe plotësimi i aktit të brendshëm/rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, me të gjitha elementet ligjore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, në rregullore duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave.

5. Konstatohet se Kontrolluesi ka emëruar nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale (DPO). Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin e njoftimit të Zyrës së Komisionerit për emërimin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 34 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se njoftimi për emërimin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale ka karakter të menjëhershëm dhe duhet të përmbushet pas kryerjes së aktit të emërimit. Kryerja e njoftimit me vonesë nuk mund të konsiderohet si përmbushje në kohë e këtij detyrimi, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 34 të Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 08.07.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës ka deklaruar angazhimin për

rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit, me shkresën e datës 08.07.2026, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1353/9 prot., datë 08.07.2026, Kontrolluesi ka paraqitur pretendimet me shkrim lidhur me konstatimet e grupit të hetimit, si më poshtë:

- Lidhur me pikën 2 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se dokumentacioni provues lidhur me asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave ka ekzistuar në momentin e hetimit administrativ, por nuk është vënë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit gjatë procesit të hetimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese në mënyrë që të jetë në gjendje të japë informacion lidhur me përputhshmërinë me këtë Ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi dhe mosdokumentimi i procedurave të brendshme rregullatore për asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, demonstroi mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përputhje me nenin 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dhe të jetë në gjendje të vërë në dispozicion dokumentacionin që provon pajtueshmërinë e veprimtarive të përpunimit me kërkesat e Ligjit. Ky detyrim nuk kufizohet vetëm në ekzistencën formale të dokumentacionit, por përfshin edhe disponueshmërinë e tij gjatë ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse të Komisionerit, me qëllim verifikimin efektiv të respektimit të dispozitave ligjore.

Për rrjedhojë, fakti që dokumentacioni i pretenduar nuk është paraqitur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, pavarësisht se Kontrolluesi pretendon se ai ekzistonte, nuk e përjashton përgjegjësinë e tij për të provuar pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit. Përkundrazi, mosvënja në dispozicion e këtij dokumentacioni gjatë kontrollit administrativ tregon se Kontrolluesi nuk ka qenë në gjendje të demonstrojë përputhshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në momentin e verifikimit, në kundërshtim me parimin e llogaridhënies.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ nuk u evidentua ekzistenca e procedurave të brendshme të dokumentuara që rregullojnë mënyrën dhe afatet e asgjësimit të të dhënave personale, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe kërkesat e Vendimit nr. 6. Kjo situatë dëshmon mungesë të masave organizative dhe dokumentare të nevojshme për garantimin e pajtueshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe evidenton se Kontrolluesi nuk ka krijuar një sistem të brendshëm efektiv të administrimit dhe dokumentimit të proceseve të asgjësimit të të dhënave personale.

Për më tepër, dokumentacioni i paraqitur vetëm pas përfundimit të fazës së hetimit administrativ nuk mund të konsiderohet si provë që përjashton konstatimin e shkeljes, pasi objekti i verifikimit lidhet me ekzistencën dhe zbatimin efektiv të masave organizative në kohën e ushtrimit të kontrollit. Për rrjedhojë, pretendimi i Kontrolluesit nuk përbën shkak për ndryshimin e konstatimeve të procesverbalit të hetimit administrativ.

- Lidhur me pikën 3 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se aneks-marrëveshja me subjektet IuteCredit Albania sh.a. dhe IutePay sh.p.k. kanë ekzistuar në momentin e hetimit administrativ, por nuk kanë qenë të bashkëngjitura si aneks i kontratave përkatëse.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Çdo delegim i përpunimit të të dhënave personale duhet të realizohet përmes një kontrate/marrëveshjeje të shkruar dhe të detajuar, e cila përcakton qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave, masat e sigurisë që do të zbatohet përpunuesi, përgjegjësitë ligjore dhe procedurat për kontrollin dhe raportimin. Kjo siguron që delegimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit.

Ky dokumentacion duhet të ekzistojë në momentin e fillimit dhe gjatë gjithë periudhës së marrëdhënies së përpunimit, si dhe të jetë i disponueshëm për t'u paraqitur pranë autoritetit mbikëqyrës gjatë ushtrimit të kompetencave të tij. Pretendimi se marrëveshjet kanë ekzistuar, por nuk u janë bashkëngjitur kontratave ose nuk janë vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, nuk përjashton përgjegjësinë e Kontrolluesit për të provuar pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit.

Mungesa e paraqitjes së këtyre marrëveshjeve gjatë procesit të hetimit administrativ ka pamundësuar verifikimin nëse marrëdhëniet me subjektet IuteCredit Albania sh.a. dhe IutePay sh.p.k. ishin të rregulluara në përputhje me kërkesat e nenit 26 të Ligjit, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të palëve, masat teknike dhe organizative të sigurisë, detyrimin e konfidencialitetit, kushtet për angazhimin e nënpërpunuesve, si dhe procedurat për asistimin e kontrolluesit në garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Për më tepër, dokumentacioni i paraqitur vetëm pas përfundimit të fazës së hetimit administrativ nuk mund të konsiderohet si provë që përjashton konstatimin e shkeljes, pasi vlerësimi i pajtueshmërisë bazohet në gjendjen faktike dhe dokumentare që ekziston dhe mund të provohet në momentin e ushtrimit të kontrollit. Për rrjedhojë, mosvënja në dispozicion e marrëveshjeve gjatë hetimit administrativ përbën një pamundësi të Kontrolluesit për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 26 të Ligjit, në kundërshtim me parimin e llogaridhënies, dhe nuk përbën shkak për ndryshimin e konstatimeve të procesverbalit të hetimit administrativ.

- Lidhur me pikën 4 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi paraqet se gjatë seancës dëgjimore ka ndërmarrë masat e nevojshme për rishikimin në funksion të përputhshmërisë me ligjin të rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke shtuar dispozitat e nevojshme lidhur me kategoritë e të dhënave personale sipas subjekteve përkatëse, të drejtat e subjekteve të të dhënave, nivelet e aksesit në të dhënat personale sipas roleve dhe funksioneve të punonjësve, si dhe masat teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së përpunimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga aksesit i paautorizuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Ndërmarrja e masave korrigjuese dhe përditësimi i dokumentacionit të brendshëm përbëjnë një tregues të vullnetit të Kontrolluesit për të përmirësuar nivelin e pajtueshmërisë me kërkesat e Ligjit. Megjithatë, këto masa janë ndërmarrë vetëm pas konstatimeve të evidentuara gjatë hetimit administrativ dhe nuk ndryshojnë faktin se në momentin e ushtrimit të kontrollit Kontrolluesi nuk dispononte një rregullore të brendshme të plotë, të përditësuar dhe të përshtatur me veprimtaritë konkrete të përpunimit që zhvillonte.

Në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin e vazhdueshëm të krijojë, zbatojë dhe përditësojë dokumentacionin e brendshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar që përpunimi i të dhënave personale të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore. Ky është një detyrim që duhet të përmbushet përpara dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive të përpunimit, dhe jo vetëm pasi autoriteti mbikëqyrës ka konstatuar mangësi ose ka filluar një procedurë administrative.

Fakti që Kontrolluesi ka përditësuar rregulloren me dispozita mbi kategoritë e të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave, nivelet e aksesit sipas roleve dhe funksioneve, si dhe masat teknike dhe organizative të sigurisë, tregon se këto elemente thelbësore mungonin ose nuk ishin të rregulluara.

- Lidhur me pikën 5 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se emërimi i nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale (DPO) është kryer në datën 05.02.2026. Gjithashtu, Kontrolluesi pretendon se menjëherë pas konstatimit të grupit të hetimit administrativ të mosrealizimit në kohë të njoftimit të DPO-së, ka ndërmarrë masat për përmbushjen e këtij detyrimi pranë Zyrës së Komisionerit dhe janë rishikuar procedurat e brendshme të pajtueshmërisë për të siguruar përmbushjen e detyrimeve procedurale brenda afateve ligjore në të ardhmen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit për emërimin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të dhënat e kontaktit të tij, në mënyrë që autoriteti mbikëqyrës të ushtrojë kompetencat e tij dhe subjektet e të dhënave të kenë mundësi të kontaktojnë personin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Ky veprim është një detyrim procedural me karakter të menjëhershëm, i cili duhet të përmbushet pa vonesë pas emërimit të DPO-së dhe nuk është në varësi të fillimit të një procedure mbikëqyrëse apo konstatimit të Zyrës së Komisionerit. Përmbushja e

këtij detyrimi vetëm pas evidentimit të shkeljes gjatë hetimit administrativ nuk mund të konsiderohet si respektim në kohë i kërkesave të Ligjit dhe nuk përjashton përgjegjësinë e Kontrolluesit për mosrespektimin e afateve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 34 të Ligjit.

Gjithashtu, fakti që Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin e njoftimit vetëm pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, konfirmon se detyrimi ligjor nuk është respektuar në mënyrën e kërkuar nga Ligji. Për këtë arsye, pretendimi i Kontrolluesit nuk përbën shkak për ndryshimin e konstatimeve të procesverbalit të hetimit administrativ, ndërsa masat korrigjuese të ndërmarra mund të merren në konsideratë vetëm si rrethana lehtësuese në vlerësimin e sjelljes së mëvonshme të Kontrolluesit, pa ndikuar në ekzistencën e shkeljes së konstatuar.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimit të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 26, 27, 28, 34, 81-84, të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin, duke specifikuar detyrimet midis palëve dhe masat tekniko-organizative, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
2. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke parashikuar në të masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit, afatet e ruajtjes, të dhënat e kontaktit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave etj.;
3. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., të ketë në vëmendje dokumentimin e veprimtarisë së përpunimit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me ligjin, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit.
4. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., të ketë në vëmendje zbatimin e rregullave të brendshme mbi trajtimin, aksesin dhe shpërndarjen e të dhënave personale, me qëllim parandalimin e përpunimeve të paautorizuara dhe rritjen e nivelit

të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit;

5. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., të marrë masa lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, sipas parashikimeve të nenit 34 të Ligjit;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 më sipër
 - ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 1 më sipër;
 - iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër;
 - iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

7. Kontrolluesi, Shoqëria “SuperMart Albania” sh.p.k., të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;
8. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 24.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi